



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE TË VJETRA

Gusht 2013

Parathënie

Reduktimi i lëndëve të vjetra është një nga çështjet më kritike me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës. Qëllimi i këtij dokumenti është paraqitja e një vizioni të përgjithshëm strategjik për adresimin e lëndëve të vjetra të cilat ekzistojnë nëpër gjykatat e Kosovës.

Në vend se të propozojë veprime specifike, kjo Strategji do të udhëzojë përpilimin e politikave, të rregulloreve të brendshme, të procedurave, standardeve, si dhe të nismave, ndërhyrjeve dhe veprimeve.

Synim i kësaj strategjie gjithëpërfshirëse është zhvillimi i një qasjeje tre-faqore me qëllim të adresimit të çështjes së reduktimit të lëndëve të vjetra nëpërmjet këtyre institucioneve:

- 1) Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Këshilli do të sigurojë përpilimin e politikave të përgjithshme, do të sigurojë leadershipin dhe përkrahjen e brendshme dhe të jashtme për zbatimin e Strategjisë dhe të nismave dhe aktiviteteve të cilat ndërlidhen me të.
- 2) Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës - Sekretariati do të sigurojë përkrahjen operacionale, buxhetore, teknike, administrative dhe logjistike për zbatimin e Strategjisë dhe të nismave dhe aktiviteteve të cilat ndërlidhen me të.
- 3) Gjykatat e Kosovës - Gjykatat do të sigurojnë mbikëqyrjen e përditshme gjyqësore dhe menaxheriale për zbatimin e Strategjisë dhe të nismave dhe aktiviteteve të cilat ndërlidhen me të.

Me qëllim që Strategjia të funksionojë, secili institucion duhet të njeh, të kujdeset dhe t'i zotohet ndërvlerësive që secili institucion e ka ndaj njëri-tjetrit. Puna në bashkëpunim, komunikimi i rregullt dhe i sigurt, si dhe përgatitja e nismave për bashkëpunim dhe koordinim, janë me rëndësi kritike për suksesin e kësaj Strategjie.

Qëllimet strategjike

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj Strategjie është reduktimi sa më i madh i lëndëve të vjetra me të cilat përballen gjykatat e Kosovës. Kjo përfshinë lëndët të cilat janë klasifikuar "si të vjetra" dhe ato lëndë të cilat do të bëhen "të vjetra" po që se nuk ndërmerren veprime me kohë për zgjidhjen/mbylljen e tyre. Strategjia tanimë përkufizon lëndët e vjetra si lëndë të cilat janë parashtruar para vitit 2012, do të thotë të gjitha lëndët e parashtruara gjer më 31 dhjetor 2011. **Deri ne gusht 2013, janë përafërsisht 142.000 lëndë të përkufizuara si të vjetra, duke përfshirë përafërsisht 91.000 lëndë në përmbarrim.** Pasi që baza e të dhënave të bëhet plotësisht operacionale dhe të konfirmohet saktësia e të dhënave, Këshilli do të shqyrtojë idenë e përkufizimit të lëndëve të vjetra si lëndë të cilat janë më të vjetra sesa dy vite.

Me qëllim të përgatitjes së veprimeve specifike të nevojshme për reduktimin e lëndëve të vjetra, kjo Strategji vendos këto qëllime:

Qëllimi strategjik 1 - Gjyqësori i Kosovës ka një pako të termave të përkufizuar dhe të paradigmave operacionale të cilat qeverisin me politikat, punën dhe administrimin e gjykatave. Prandaj secila gjykatë, KGjK-ja dhe Sekretariati mund të bashkërendojnë dhe të komunikojnë më mirë në lidhje me numrin e lëndëve dhe ngarkesën e punës në çdo gjykatë.

Qëllimi strategjik 2 - Gjyqësori i Kosovës raporton lëndët me kohë, në mënyrë të besueshme dhe të saktë, dhe ka statistikën rreth ngarkesës me punë. KGjK-ja dhe Gjykatat nuk mund të përpilojnë politikat dhe procedurat e duhura operacionale pa ditur hollësitë e lëndëve të cilat janë parashtruar nëpër Gjykata. Është me rëndësi të madhe që gjyqësori të dijë saktësisht sa lëndë janë nëpër të gjitha gjykatat në Kosovë, llojin e tyre dhe cilit gjyqtar i janë caktuar.

Qëllimi strategjik 3 - Gjykatat themelore kanë përpiluar, kanë nisur zbatimin dhe po mbikëqyrin zbatimin e planeve të veprimit për reduktimin e lëndëve të vjetra për secilën gjykatë. Përderisa KGjK-ja mund të vendosë politikat dhe udhëzimet, dhe Sekretariati mund të ofrojë përkrahje administrative, teknike dhe logjistike, secila Gjykatë Themelore e din numrin e lëndëve në pritje dhe lëndëve të parashtruara në rajonin e gjykatës përkatëse. Është me rëndësi kritike që Gjykatat të kenë mandatin për të menduar me kreativitet rreth përpilimit të planeve individuale të veprimit.

Qëllimi strategjik 4 - KGjK-ja ka krijuar partneritete strategjike dhe operacionale me institucionet e jashtme siç është KPK-ja, policia, autoritetet postare, bankat, qendrat e ndërmjetësimit, donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat tjera që ndërlidhen me qëllim e ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të procedurave të cilat do të shkurtojnë kohën dhe koston në lidhje me njoftimet, ndarjen e informacionit dhe zgjidhjen e lëndëve në pritje.

Qëllimi strategjik 5 - KGjK-ja me asistencë nga Sekretariati ka përpiluar politikat për alokim të resurseve dhe të buxhetit në bazë të matjeve sasiore. Përderisa nevoja për rritje të numrit të gjyqtarëve dhe të personelit shpeshherë përmendet si përgjigjja e parë ndaj reduktimit të lëndëve të vjetra, gjyqësori i Kosovës duhet të jetë në gjendje që të merr vendimet politike dhe procedurale

brenda buxhetit apo resurseve të tanishme, e ndonjëherë edhe me resurse dhe buxhet të zvogëluar. Sa i përket këtij qëllimi, të gjitha nismat dhe aktivitetet e planifikuara për të adresuar lëndët e vjetra duhet të përfshijnë edhe implikimet buxhetore.

Qëllimi strategjik 6 - Sekretariati dhe Gjykatat e Kosovës kanë resurset adekuate të automatizimit, kompjuterizimit dhe menaxhimit të informatave ashtu që KGjK-ja dhe Gjykatat mund të marrin vendimet për menaxhim dhe të bëjnë politikat e arsyetuara, në bazë të informatave dhe me kohë. Kjo do të përfshijë përgatitjen, shpërndarjen dhe përditësimin e raporteve në lidhje me lëndët në pritje.

Qëllimi strategjik 7 - KGjK-ja në bashkërendim me Gjykatat ka përgatitur standardet kuptimplota kohore për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të të gjitha lëndëve. Këtu synohet që numri i lëndëve të vjetra të mos vazhdojë të rritet.

Qëllimi strategjik 8 - KGjK-ja ka përpiluar politika dhe procedura kuptimplota për performancën dhe vlerësimin e gjyqësorit të cilat kuptohen nga gjyqtarët, dhe të cilat i raportohen publikut. Publiku duhet të kuptojë se gjyqtarët japin llogari për lëndët të cilat i janë caktuar, e kjo do të ndërtojë besimin dhe kuptimin më të mirë rreth punës së gjykatave.

Qëllimi strategjik 9 - Gjyqtarët, në bashkëpunim me KGjK-në dhe IGjK-në, kanë vijuar trajnimin adekuat për të kryer detyrat e veta administrative, ligjore dhe gjyqësore në nivelet më të larta të mundshme.

Qëllimi strategjik 10 - Gjykatat kanë numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve të caktuar nëpër departamente në mënyrën më efikase dhe efektive në pajtim me ligjet të cilat rregullojnë caktimet gjyqësore.

Qëllimi strategjik 11 - Do të përfundohen të gjitha lëndët përmbarimore.

Zbatimi i strategjisë

Përderisa qëllimi i kësaj Strategjie nuk është përpilimi i listës së aktiviteteve për KGjK-në, Sekretariatit apo Gjykatat, ekzistojnë disa nisma të cilat ia vlen të eksplorojnë. Këto nisma mund të përfshijnë:

- Identifikimin e lëndëve të vjetra (p.sh. cilat lëndë janë përkufizuar si "lëndë të vjetra"). Tani ekziston baza e të dhënave për lëndët e vjetra nga e cila mund të nxirren raportet rreth llojit të lëndës, vjetërsisë, lokacionit, palëve, e kështu me radhë. Kjo bazë e të dhënave mund të shfrytëzohet për të gjeneruar listën/raportin e lëndëve të vjetra (përfshirë lëndët e identifikuar si "të vjetra") për çdo gjykatë që identifikon çdo lëndë dhe tregon statusin aktual të secilës lëndë. Brenda këtyre rezultateve gjykatat mund të identifikojnë lëndët të cilat kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, siç janë lëndët të cilave u ka kaluar periodha e parashkrimit, lëndët pa aktpadi, e kështu me radhë.

- Kryerjen e një studimi për të përcaktuar shkaqet kryesore të krijimit të lëndëve të vjetra.
- Përpilimi i planeve specifike të veprimit për reduktimin e lëndëve të vjetra për kah lloji i lëndës.
- Udhëzimin e kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve mbikëqyrës dhe administratorëve të gjykatave për të siguruar futjen dhe përditësimin e informatave rreth lëndëve në bazën e të dhënave.
- Rishikimin e caktimeve aktuale në gjyqësor për të parë nëse gjyqtarët mund të ri-caktohen apo të transferohen përkohësisht me qëllim të reduktimit të lëndëve të vjetra në gjykatat tjera.
- Përpilimin e raporteve të thjeshtësuara statistikore të cilat lexohen me lehtësi në lidhje me numrin/llojin/statusin e lëndëve të vjetra në çdo gjykatë, gjë që ndihmon në menaxhimin e lëndëve të vjetra nga kryetarët e gjykatave, gjyqtarët mbikëqyrës dhe administratorët e gjykatave.
- Gjykatat (gjyqtarët, administratorët dhe referentët) përpilojnë planet e tyre për të trajtuar ngarkesën me lëndët e vjetra.
- Takimin me KPK-në, policinë, autoritetet postare, bankat, qendrat e ndërmjetësimit dhe organizatat tjera përkatëse me qëllim të identifikimit dhe përmirësimit të procedurave apo politikave të cilat ulin efikasitetin gjatë procedimit të lëndëve.

Kjo Strategji për reduktimin e lëndëve të vjetra në Gjykatat e Kosovës është dokument udhëzues për gjyqtarët, administratorët dhe për stafin gjyqësor. Numri i lëndëve të vjetra do të reduktohet dhe do të evitohet vetëm nëpërmjet zotimit dhe këmbëngulësisë së të lartpërmendurve. Përderisa numri i lëndëve mund të duket i frikshëm, KGjK-ja, Sekretariati dhe Gjykatat kanë kapacitetin për të gjetur zgjidhje kreative, funksionale dhe të qëndrueshme për të adresuar reduktimin e lëndëve të vjetra.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE TË VJETRA

PLANI I ZBATIMIT

Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra do të zbatohet nëpërmjet këtyre detyrave:

Detyrat përgatitore

- Analiza (statistikat) e lëndëve të vjetra
 - Të gjendet numri dhe lloji i lëndëve, përfshirë gjykatat dhe gjyqtarët ku gjenden lëndët e vjetra
 - Të konfirmohen lëndët e vjetra nëpërmjet rishikimit të lëndëve
 - Të rishikohet dhe të shihet nëse ka lëndë të cilave u ka skaduar periudha e parashkrimit
- Të sigurohet plotësimi i të gjitha kërkesave procedurale për koordinim me agjencitë tjera qeveritare, për shembull me Ministrinë e Drejtësisë
- Kryerja e një studimi për të parë shkaqet kryesore të krijimit të lëndëve të vjetra.
- Rishikimi i ngarkesës me punë/me lëndë për çdo gjyqtarë, përfshirë përqindjen e lëndëve të vjetra nga totali
- Rishikimi/analiza e shpërndarjes së barrës së punës brenda secilës gjykatë dhe brenda gjyqësorit në përgjithësi
- Adresimi i kërkesave buxhetore, përfshirë TI, hapësira pune dhe resurset njerëzore.

Detyrat për menaxhmentin e gjykatave

- Të vendoset norma për lëndët e vjetra që duhet të zgjidhen për kah lloji i lëndës
 - Krijimi i komisionit për reduktimin e lëndëve të vjetra
 - Çdo gjykatë dhe gjyqtar të ketë planin individual për reduktim të lëndëve të vjetra
 - Duhet të përshtaten normat gjyqësore
 - Të përshtatet niveli i stafit dhe sistematizimi i tërë stafit
 - Ri-caktimet në gjyqësor
- Sa i përket lëndëve të cilave u ka skaduar periudha e parashkrimit, të përpilohen disa shabllone të aktvendimeve për të hedhur poshtë ato lëndë.
- Nëse nevojitet, të përgatiten kërkesat specifike buxhetore
- Përgatitja e nismave për zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve

Detyrat e KGjK-së

- Krijimi/shpërndarja e raporteve statistikore

- Ricaktimi i gjyqtarëve sipas nevojës
- Kërkimi i resurseve shtesë, nëse nevojiten
- Përgatitja/zbatimi/publikimi i veprimeve të mundshme në lidhje me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve të cilët nuk reduktojnë numrin e lëndëve të vjetra që iu është caktuar atyre.
- Përgatitja/zbatimi/publikimi i sanksioneve të mundshme dhe ndëshkimeve ndaj avokatëve/palëve të cilët nuk veprojnë me kohë ose të cilët dështojnë të veprojnë sipas udhëzimeve të gjykatës
- Përgatitja e memorandumeve të mirëkuptimit me akterët tjerë që ndërlidhen në punët procedurale, p.sh. PTK - për dërgimin e letrave
- Përgatitja dhe propozimi i ndryshimeve të ligjeve
- Përgatitja e shablloneve procedurale për çdo lëndë të gatshme për aktgjykim, përfshirë ato lëndë ku ka gatishmëri për zgjidhje apo pranim të fajësisë
- Sigurimi i burimeve plotësuese të punës me kosto të ulët, siç janë praktikantët.